



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 437/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se KQZ-ja, ka dhënë përgjigje të pasaktë në kërkesën e datës 10.12.2010 nr. 1556/2010, sipas kërkesës së bërë nga subjekti politik LVV të datës 03.12.2010, më të cilën ishte kërkuar shkarkimi i kryetarit të KKZ-së dhe decertifikimin e KVV të cekur më emër në kërkesë në komunën e Malishevës.

Subjekti politik LVV konsideron se në këtë rast është bërë shkelje e nenit 70 paragrafi 1 pika (b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë: Njoftimin e datës 30.11.2010 nr. 4 dorëzuar në KKZ-së në Malishevë, Kërkesa më datë 03.12.2010 dërguar KQZ-së Prishtinë dhe tabelën më nr. 2 me emrat e anëtarëve të KVV-së. Më propozim që urgjentisht të jap urdhër KQZ-së për decertifikimin e komisionarëve (KVV) dhe emërimin e komisionarëve tjerë rezervë.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se KQZ-ja nuk ka dhënë përgjigje të saktë në kërkesën e bërë më datë 10.12.2010 nr. 1556/2010, nga subjekti politik LVV, nuk është paraparë në ndonjë dispozitë ligjor të LZP-së e as me Rregulla Zgjedhore që PZAP-i, të merr ndonjë vendim kur ankuesi pretendon se KQZ-ja nuk ka dhënë përgjigje të saktë ndaj kërkesës së bërë. PZAP-i duke u bazuar në nenin 119.3 dhe 122.1 të LZP-së vendos vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së kur personit fizik apo juridik të cilit i janë prekur të drejtat ligjore, prandaj duke u bazuar në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 637/2010 më datën 23.12.2010.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

